

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

Xhezair ZAGANJORI	Kryesues
Evelina QIRJAKO	Anëtare
Medi BICI	Anëtar

Mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit të datës 11.02.2016, çështjen administrative që i përket:

PADITËS: Does Derveni

E PADITUR : Drejtoria Rajonale Arsimore Qarku Fier

OBJEKTI : *Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me 12 paga për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës; 2 paga për mosrespektim të procedurës; 3 paga për mosrespektim të afatit; shpërblim për vjetërsi në punë në masën e 3 pagave mujore.*

BAZA LIGJORE: *Ligji 49/2012, nenet 32, 153-156 të K.Pr.Civile, Nenet 12, 134, 144, 145, 153, 155 të K.Punës, Neni 144 i Kushtetutës, Ligji 69/2012, Udhëzimi nr. 3 datë 18.01.2011 i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Udhëzimi nr. 199 datë 01.12.2010 i Kryeministrit, Udhëzimi nr. 22 datë 11.10.2010 “Për emërimin e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar”.*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 98 datë 06.02.2014 ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen me pagën e një viti për zgjidhjen e menjëhershme de të pajustificuar të kontratës së punës.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen me 3 muaj pagë për mosrespektimin e afatit të zgjidhjes së kontratës së punës.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen me 3 muaj pagë për vjetërsinë.

Detyrimin e të paditurit të dëmshpërblejë paditësen përfundimisht me 20 paga mujore.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 2105 datë 28.05.2014 ka vendosur:

Mospranimin e ankimit për palën e paditur Drejtoria Arsimore RAjonale Fier, kundër vendimit nr. 98 datë 06.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Kundër vendimit nr. 2105 datë 28.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar rekurs pala e paditur Drejtoria Arsimore Rajonale Fier, e cila ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.2105 datë 28.05.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 11.02.2016

Nr. 31003-00610-00-2015 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2016-1462 i Vendimit (96)